Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/293
Datë: 07.05.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, bazuar në Rregulloren Nr. 01/2020 për përcaktimin e procedurave për Aplikim të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak, neni 5 paragrafi 4, 5 dhe 6, si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. REFUZOHET aplikacioni/kërkesa Nr.01/710 e dt. 13.11.2023 e Institucionit për Arsim dhe Aftësim Profesional "Akademia Profesionale DC" me adresë: Veranda D4, Hyrja B, Lagjja Kalabria, (Rruga për Veternik) 10.000, Republika e Kosovës, për akreditim dhe validim për kualifikimet: Asistent i Fizioterapisë niveli III dhe IV i KKK dhe Teknik i Laboratorit Mjekësor niveli III dhe IV i KKK.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucionit për Arsim dhe Aftësim Profesional "Akademia Profesionale DC" me adresë: Veranda D4, Hyrja B, Lagjja Kalabria, (Rruga për Veternik) 10.000, Republika e Kosovës, me datë 13.11.2023 ka parashtruar në AKK aplikacionin/kërkesën nr. 01/710 për akreditim dhe validim të kualifikimeve: Asistent i Fizioterapisë niveli III dhe IV i KKK dhe Teknik i Laboratorit Mjekësor niveli III dhe IV i KKK.

Ekspertet e AKK-së brenda afatit ligjor kanë marrë në shqyrtim për vlerësim aplikacionin e dorëzuar nga ana e Institucionit për Arsim dhe Aftësim Profesional "Akademia Profesionale DC".

Me datë 08.03.2024, ekspertet e AKK-së përmes emalit zyrtar bazuar në nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 01/521 për përcaktimin e procedurave për Aplikimin e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional, për proces të akreditimit institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve, si dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak pas

konstatimeve se aplikacioni nuk është i kompletuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, kanë kërkuar nga institucioni që në afat prej një (1) jave ta plotësojnë aplikacionin bazuar në udhëzimet e eksperteve të AKK-së dhe të njëjtin pas përmirësimeve ta dorëzojnë në AKK për vlerësim. Por institucioni aplikues nuk ka konfirmuar pranimin e email-it dhe pas bisedes përmes telefonit, zyrtarët e AKK-së përsëri me datë 18.03.2024 i kanë ridërguar emalin e dt.08.03.2024 lidhur me plotësimin e dosjes.

Ekspertët e AKK- së me datë 19.04.2024 kanë hartuar raportin vlerësues për aplikacionin e Institucionit për Arsim dhe Aftësim Profesional "Akademia Profesionale DC" dhe kanë konstatuar se edhe pas rishikimit të dosjes në afatin e dhënë nga AKK pala aplikuese nuk ka bërë përmirësimet e kërkuara. Andaj, bazuar në nenin 7 paragrafi 2 dhe 7 të Rregullores Nr. 01/521 për përcaktimin e procedurave për Aplikimin e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional, për proces të akreditimit institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve, si dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak ekspertet e AKK-së i kanë rekomanduar Këshillit Drejtues që aplikacioni të refuzohet.

Ekspertet e AKK-së në raportin vlerësues të aplikacionit kanë konstatuar se: Dëshmia për pronësi ose marrjen me qera të objektit me vlefshmëri kohore së paku për kohën e akreditimit nga ana e institucionit nuk mbulon kohëzgjatjen e kërkuar për akreditim nga ana e institucionit.
Sa i përket rregullores së punës institucioni ka ofruar dy rregullore me përmbajtje të ndryshme, rregullorja e dorëzuar në formë fizike është e nënshkruar kurse rregullorja e dorëzuar në dosjen elektronike ka përmbajtje tjetër dhe nuk është e nënshkruar dhe e vulosur.

Në dosjen e aplikimit mungon lista për paisjet dhe materialet të cilat duhet të jenë në dispozicion për ofrimin dhe vlerësimin e kualifikimit/modulit në përputhje me numrin e nxënësve/kandidatëve. Në dosje e aplikimit mungon CV-ja e z. Osman Salihu mësimëdhënës i lëndës së fizikës tek kualifikimi Asistent i Fizioterapisë. Sa i përketë kontratave të punës (valide) së paku për kohën e kërkuar për akreditim, kontratat e ofruara në dosjen fizike nga institucioni nuk e mbulojnë përiudhën e kërkuar për akreditim sepse të njëjtat skadojnë me 31.06.2025, e po ashtu mungojn kontratat e z. Islam Sejdiut dhe znj. Erdeta Ibrahimit. Andaj, Institucioni nuk ka vepruar në përputhje me nenin 10 paragrafi 1 pika 1.12 sepse institucioni aplikues duhet të ofroj kontratë ligjore të arritur me stafin për periudhën e caktuar, e po ashtu kontratat e dërguara në formë elektronik janë të pa nënshkruara dhe të pa vulosura.

Ekspertet e AKK-së kanë konstatuar se plani i biznesit dhe plani financiar i IAAP-së për së paku tri vite nuk mbulon tri vite siç kërkohet bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushë veprimtaria e AKK-së. Rregulloret e brendshme të institucionit për implementimin e sigurimit të cilësisë të ofruara në dosjen elektronike janë sjellur të pa nënshkruara dhe pa vulosura edhe pas kërkesës për përmirësim të dosjes së aplikimit.

Institucioni aplikus nuk ka nxjerrë vendim për përcaktimin e përsonit përgjegjës për sigurimin e cilësisë por ka ofruar një njoftim të pa nënshkruar në dosjen elektronike dhe një kontratë pune në dosjen fizike me të cilën z. Lavdim Uka është caktuar koordinator për sigurimin e cilësisë, por kontrata nuk mbulon periudhën e kërkuar për akreditimit për tri vite sepse kontratae z. Uka përfundon me datë 18.10.2024. Institucioni aplikues ka dorëzuar në dosjen elektronike rregulloren për regjistrimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve/nxënësve, e cila është e pa vulosur dhe pa përcaktuar kohën kur rregullorja hyn në fuqi, ndërsa edhe rregullorja për lëshimin, zëvendësimin

e certifikatave në raste kur origjinalet janë humbur ose dëmtuar është e mangët dhe në dosjen elektronike mungon.

Lidhur me dokumentet mbi politikat zhvillimore të stafit, analizat e nevojave për trajnim, shqyrtimi i përformancës dhe monitorimi i stafit institucioni aplikues ka ofruar dokument të mangët sepse nuk ka planifikime kohore, e as përshkrime të mjaftueshme se si do të bëhët zhvillimi i stafit profesional.

Gjatë vlerësimit të dosjes së aplikimit të institucionit aplikues ekspertet e AKK-së kanë konstatuar edhe këto mangësi:
Procedurat për njohjen e kredive nga institucionet tjera është e mangët si dokument, portfolio reale e dorëzuar në formë fizike e një kandidati që dëshmonë procedurën që nga regjistrimi deri në certifikim e ofruar nga institucioni nuk është e njëjtë me atë të dërguar në dosjen eletronike.
Në dosjen elektronike Rregullorja per Siguri dhe Shëndet në Punë është e pa vulosur dhe pa nënshkruar. Po ashtu është i bashknagjitur edhe plani i evakuimit si dëshmi por ky plan në titull dhe përmbajtje është i Bau Academy por në fund është nënshkruar nga Natyra Gruda dhe e vulosur nga Akademia profesionale DC. Kurse ne dosjen elektronike është plani i evakuimit po i njejti sikurse ne dosjen fizike vetëm se subjekti është ndryshuar është Akademia Profesionale DC dhe është i pa nënshkruar dhe i pa vulosur.

Korniza Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë nuk është sipas versionit të fundit të AKK, por është paraqitur një format i cili nuk përkon me versionin e publikuar në web faqën e AKK-së, si dhe në dosjen elektronike nuk është e nënshkruar. Institucioni aplikues ka dorëzuar planin e përmirësimit të pa nënshkruar si dhe në dosje ka munguar kostoja e planit të përmirësimit.

Ekspertet e AKK-së pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit kanë konstatuar se Institucioni aplikues Akademia Profesionale DC nuk ka treguar seriozitet me rastin e rishikimit të dosjes së tyre sepse nuk janë bërë përmirësimet e kërkuara nga AKK. Në dosjen për kualifikimin Asistent i Fizioterapisë është i bashkangjitur plani i evakuimit si dëshmi por ky plan është i Bau Academy dhe po pikërisht këtij plani i është bashkangjitur rregullorja për përcaktimin e procedurave për raportimin e incidenteve nënshkruar nga Natyra Gruda. Kurse në dosjen elektronike është plani i evakuimit po i njëjti sikurse në dosjen fizike vetëm se subjekti është ndryshuar është Akademia Profesionale DC dhe është i pa nënshkruar dhe i pa vulosur.

Gjithashtu në dosjen e kualifikimit Teknik i Laboratorit Mjekësor, ky institucion ka bashkangjitur planin e evakuimit si dëshmi por ky dokument në titull dhe përmbajtje përsëri është i institucionit Bau Academy dhe në fund dokumenti është i nënshkruar direkt nga Natyra Gruda në vitin 2017. Kurse në dosjen elektronike është plani i evakuimit po i njëjti sikurse në dosjen fizike vetëm se subjekti është ndryshuar është Akademia Profesionale DC dhe është i pa nënshkruar dhe vulosur.

Këshilli Drejtues i AKK-së vendosi bazuar në raportin vlerësues të ekspertëve të AKK-së bazuar në dëshmitë e ofruara nga institucioni aplikues në dosjen fizike dhe elektronike.

Andaj, bazuar në të lartcekurat dispozitat ligjore në fuqi dhe pas analizimit të raportit vlerësues të eksperteve të AKK-së Këshilli Drejtues i AKK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit për Arsim dhe Aftësim Profesional "Akademia Profesionale DC"
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së